

## Fjalim hyrës

z. Stiv Tom  
Këshilltar i lartë  
Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, WIPO  
Konferencë  
”KRIJIMI I TREGJEVE NGA REZULTATET E KËRKIMEVE”  
Muzeu i luftës maqedonase  
29 nëntor 2013  
Shkup

Të nderuar mysafirë, zonja dhe zotërinj,  
Është kënaqësi e madhe sot t'ju drejtohem në Shkup në këtë përvjetor të rëndësishëm në emër të Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, Fransis Gari. Për fat të keq, Drejtori i Përgjithshëm nuk është në gjendje të jetë me ne këtë mëngjes dhe kështu unë do të doja të përcjellë fjalët e tij të mirëseardhjes.

”Zonja dhe zotërinj,

Privilegj i madh dhe nder për mua është që t'ju përcjellë tek ju këto fjalë me rastin e manifestimit të 20 vjetorit të themelimit të Entit shtetëror për pronësi industriale. Kjo është me të vërtetë një rast i madh dhe të gjithë kolegët e mi nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale dhe me të vërtetë, të gjithë nga bashkësia ndërkombëtare të pronës intelektuale ju dërgojnë mesazhet dhe urimet e tyre të përzemërta për këtë arritje. Më lejoni në veçanti të përshëndes sekretarin shtetëror z. Ançe Trifunov, drejtorin e Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale, z Safet Emruli, dhe i përgëzoj për këtë arritje.

Ne patëm fat të madh për të bashkëpunuar që nga viti 1993. Në vitin 1993, Maqedonia, pas shkëputjes nga ish- republika jugosllave u kyç në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe njëkohësisht iu bashkangjiti traktateve shumëpalëshe mbi pronën intelektuale që udhëheq WIPO. Që atëherë, në 20 vitet e fundit, ne kemi gëzuar një lidhje shumë të fortë dhe ne jemi veçanërisht mirënjohës për angazhimin konstruktiv dhe

vëmendjen e madhe të vendit tuaj në WIPO si dhe në agjendën ndërkombëtare për pronën intelektuale. Aktivitetet tona në bashkëpunim kyçyn, mes tjerash edhe zhvillimin e një Strategjie Kombëtare për Pronësinë Intelektuale. Ne kemi një bashkëpunim të vazhdueshëm në drejtim të sistemit tonë, të quajtur IPAS, që shërben për Modernizim dhe automatizim të Entit, kemi bashkëpunime në lidhje me zhvillimin e programit mësimor për universitetet.

Siç thashë, vlerësojmë shumë angazhimin e vendit tuaj në organizatën tonë.

I uroj të gjithë ata që janë të pranishme në Shkup me rastin e kësaj ngjarje shumë të rëndësishme, një sukses të madh dhe manifestim shumë të këndshëm dhe edhe një herë ju falënderoj për mbështetjen tuaj të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.”

Duke i bërë jehonë fjalëve të drejtorit gjeneral, unë do të doja për të nderuar arritjet në 20 vitet e fundit dhe për shumë bashkëpunim konstruktiv që është zhvilluar në mes WIPO-së dhe Entit Shtetëror. Ky bashkëpunim mbulon një gamë të gjerë të ndërtimit të kapaciteteve - nga krijimi i politikave, zhvillimi i burimeve njerëzore, ngritjen e vetëdijes dhe krijimin dhe menaxhimin e mjeteve të pronësisë intelektuale për forcimin e partneritetit në nivel ndërkombëtar dhe rajonal.

Për një kohë shumë të shkurtër është arritur aq shumë dhe kjo është një meritë e të gjithë juve.

Në të vërtetë, shihet në dritën e Indeksit Global të Inovacionit 2013 - shpallur nga WIPO, shkollë të biznesit INSEAD dhe Universiteti Kornel, ndër të tjera - Maqedonia impresionalisht është ranguar në rendin e 51 në botë, nga 62 sipas të dhënave të vitit të kaluar.

Bazuar në këto arritje, ESHPI pritet të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë dhe të ndihmojë Entin Shtetëror në realizimin e shumë projekteve të përbashkëta - nga modernizimi i sistemit IPAS deri në përparimin e mëtutjeshëm në fushën e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale dhe fazën e rëndësishme për zbatimin e saj.

Në fakt, jemi të bindur se forcimi i sistemit për pronën intelektuale është e rëndësishme që të shpërblejë Kreativitetin, stimulimin e inovacioneve dhe

dhe kontributin në zhvillimin ekonomik, social e kulturor të vendit tuaj. Ne jemi të përgatitur për të mbështetur Entin Shtetëror në këtë sipërmarrje të madhe.

Në fund, unë do të doja të falënderoj Sekretarin Shtetëror Trifunov dhe Drejtorin Emruli për mikpritjen e tyre dhe përsëri, ti përcjellë urimet më të mira të Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale për të gjithë ju.

Ne ju dëshirojmë sukses të madh në 20 vitet e ardhshme dhe vitet që pasojnë pas tyre.

Ju faleminderit.